



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 2/747
Datë: 1/10/2019

Mbështetur në kompetencat e përcaktuara me nenin 173, paragrafi 8 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037, Ligjit të Punës nr. 03/L-212, udhëzimit administrativ nr. 371, dt. 19.10.2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe udhëzimit administrativ nr. 01/2018 për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension dhe Udhëzimit Administrativ për Plotësimin dhe Precizimin (Aneksi-I-MASHT) 7/2018 e UA 01/2018 për Parimet e Njohjes së Platformave dhe Revistave Ndërkombëtare me Recension, Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e datës 09.07.2019, miratoi:

RR E G U L L O R E N

PËR PROCEDURAT PËRZGJEDHËSE LIDHUR ME EMËRIMIN, RIEMËRIMIN DHE AVANCIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave përzgjedhëse dhe procesin për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, në thirrjen profesor i rregullt, profesor i asociuar, profesor asistent, asistent dhe lektor në të gjitha fakultetet, përveç Fakultetit të Arteve.
2. Çështjet që nuk janë rregulluar në mënyrë shprehimore në Statutin e Universitetit të Prishtinës (UP) lidhur me procedurat vlerësuese për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, rregullohen në dispozitat vijuese të kësaj rregulloreje.

Neni 2

Personeli akademik

Në pajtim me nenin 171, paragrafi 2, të statutit, personeli akademik i Universitetit (përveç Fakultetit të Arteve) përbëhet nga: profesorë të rregullt; profesorë të asociuar; profesorë asistentë; asistentë universiteti dhe lektorë.

Neni 3

Kriteret për emërimin në thirrjen akademike

1. Procedura vlerësuese për emërimin në thirrjen akademike mbështetet në kriteret që dalin nga aktivitetet në vijim:
 - (1) Aktiviteti arsimor – shtojca I;
 - (2) Aktiviteti hulumtues, shkencor dhe profesional – shtojca II;
 - (3) Aktiviteti shërbyes– shtojca III.
2. Për emërimin e kandidatëve në thirrjen përkatëse kërkohet plotësimi i minimumit të kriterëve të parapara në statutin e UP-së dhe në shtojcat përkatëse të kësaj rregulloreje.
3. Shtojcat I, II dhe III janë pjesë përbërëse të rregullores.

Neni 4

Emërimi në thirrjen e profesorit të rregullt

1. Në pajtim me nenin 175 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, për titullin e profesorit të rregullt të fakultetit, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
 - 1.2. Të tregojë nivel të lartë dhe kompetencë akademike e përvojë shkencore për lëndën që dëshmohet me:
 - 1.2.1. Një numër të rëndësishëm të monografive¹, teksteve mësimore², publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore, me së paku 5 punime kryesore të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare, si autor i parë ose korrespondent;
 - 1.2.2. Pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare³;
 - 1.2.3. Përvojë afatgjatë në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme⁴;

¹ Së paku një (1) monografi; Monografi konsiderohet edhe punimi i doktoratës në formë monografie, i publikuar si botim i veçantë.

² Së paku një (1) tekst mësimor (si autor, koautor ose përkthyes).

³ Së paku tri (3) konferenca, nga të cilat së paku një (1) ndërkombëtare.

- 1.2.4. Aftësi të lartë arsimore dhe pedagogjike përmes praktikës së arsyeshme;
 - 1.2.5. Aftësi për udhëheqje akademike;
 - 1.2.6. Udhëheqje të temave master dhe të doktoratës.
2. Kandidati mund të konsiderohet si autor i parë ose korrespondent i punimeve të publikuara në revista shkencore në frymën e pikës 1.2.1 të këtij neni vetëm nëse plotësohen kriteret e specifikuar në paragrafin A të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

Neni 5

Emërimi në thirrjen e profesorit të asociuar

1. Në pajtim me nenin 176 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, për titullin e profesorit të asociuar, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
 - 1.2. Të ketë një numër të zgjedhur të monografive⁵, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore, me së paku 3 punime kryesore të publikuara në revista ndërkombëtare, si autor i parë ose korrespondent;
 - 1.3. Të tregojë aftësi për mësimdhënie;
 - 1.4. Të dëshmojë punë, dije dhe mjeshtëri në lëndën e lëmit përkatës.
2. Kandidati mund të konsiderohet si autor i parë ose korrespondent i punimeve të publikuara në revista shkencore në frymën e pikës 1.2 të këtij neni vetëm nëse plotësohen kriteret e specifikuar në paragrafin A të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

Neni 6

Emërimi në thirrjen e profesorit asistent

1. Në pajtim me nenin 177 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, për titullin e profesorit asistent, kandidati duhet të ketë këto kualifikime:
 - 1.1. Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
 - 1.2. Të ketë numër të zgjedhur të monografive⁶ dhe publikimeve të shqyrtuara në revista ndërkombëtare shkencore, me së paku një punim kryesor të publikuar dhe të shqyrtuar në revista ndërkombëtare, si autor i parë ose korrespondent;

⁴ Pjesëmarrës në së paku një (1) projekt.

⁵ Së paku një monografi; Monografi konsiderohet edhe punimi i doktoratës në formë monografie.

⁶ Së paku një monografi; Monografi konsiderohet edhe punimi i doktoratës në formë monografie.

- 1.3. Të tregojë aftësi për mësimdhënie⁷;
 - 1.4. Të ketë së paku tre vjet përvojë pune në procesin mësimor në arsimin e lartë;
 - 1.5. Kandidati i cili zgjedhet për herë të parë nuk duhet të jetë më i vjetër se 50 vjet.⁸
2. Në lëndët paraklinike specializimi nuk është i domosdoshëm. Në qoftë se kandidati që konkurren në lëndët paraklinike ka specializim, atëherë vlerësimi i atij specializimi bëhet nëpërmjet krahasimit me specializimet e përafërta të përcaktuara nga katedra përkatëse paraklinike dhe duke u bazuar në nivelin e përshtatjes me kërkesat e katedrës përkatëse.
 3. Si përvojë pune në frymën e pikës 1.4 konsiderohet përvoja të cilën kandidati e ka arritur në procesin mësimor, si i zgjedhur ose angazhuar së paku në gjashtë (6) semestra, në njërin prej institucioneve të arsimit të lartë.
 4. Kandidati mund të konsiderohet si autor i parë ose korrespondent i punimeve të publikuara në revista shkencore në frymën e pikës 1.2 të këtij neni vetëm nëse plotësohen kriteret e specifikuar në paragrafin A të shtojcës II të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Emërimi në thirrjen e asistentit të universitetit

1. Në pajtim me nenin 178 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, për titullin e asistentit të universitetit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në drejtimin përkatës, përkatësisht për Fakultetin e Mjekësisë⁹ të ketë të përfunduar Fakultetin e Mjekësisë (në rastin e lëndëve klinike, të ketë të përfunduar specializimin apo të jetë së paku në vitin e tretë të specializimit në rastin e rizgjedhjes);
 - 1.2. Të jetë jo më i vjetër se 30 vjet¹⁰ (respektivisht jo më i vjetër se 35 vjet¹¹ në Fakultetin e Mjekësisë¹²) kur emërohet për herë të parë. Përjashtimisht kandidati mund të zgjedhet asistent universiteti deri në moshën 40-vjeçare nëse ka gradën e doktorit të shkencës;
 - 1.3. Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës në universitet¹³ me rastin e

⁷ Dëshmohet me referencë nga punëdhënësi paraprak ose një mësimdhënës i fushës me titull më të lartë nga ai institucion.

⁸ “Jo më i vjetër se 50 vjet” konsiderohet periudha deri në ditën që kandidati mbush 50 vjet.

⁹ Për studimet e integruara në Fakultetin e Mjekësisë.

¹⁰ “Jo më i vjetër se 30 vjet” konsiderohet periudha deri në ditën që kandidati mbush 30 vjet.

¹¹ “Jo më i vjetër se 35 vjet” konsiderohet periudha deri në ditën që kandidati mbush 35 vjet.

¹² Për studimet e integruara në Fakultetin e Mjekësisë.

¹³ Në ndonjë institucion të arsimit të lartë.

riemërimet;

- 1.4. Të ketë notën mesatare në studimet baçelor dhe master jo më pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve.

Neni 8 **Emërimi në thirrjen e lektorit**

1. Për titullin e lektorit të gjuhëve të huaja, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:
 - 1.1. Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në gjuhën e zgjedhur¹⁴;
 - 1.2. Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës së zgjedhur;
 - 1.3. Të ketë notën mesatare të studimeve baçelor dhe master jo më pak se 8 në secilën prej këtyre studimeve.
2. Lektorët në fakultetet e tjera, pos në fakultetin amë, i kanë të gjitha të drejtat dhe obligimet për mbajtjen e ligjëratave¹⁵.

Neni 9 **Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim**

1. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të Universitetit të Prishtinës.
2. Avancimi nuk është proces automatik, por është konkurrues dhe meritore për të gjitha pozitat.
3. Anëtarët e personelit akademik që nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune primare në UP nuk mund të marrin pjesë në procedurën e avancimit në thirrjen akademike për periudhën sa nuk e kanë statusin e marrëdhënies së rregullt të punës primare me UP-në, përkatësisht nuk paraqesin dëshmi se kanë hequr dorë nga marrëdhënia e rregullt e punës në institucionin tjetër.
4. Në kategorinë e personelit akademik sipas paragrafit 3 të këtij neni bëjnë pjesë personeli që kanë qenë në marrëdhënie të rregullt të punës në UP dhe ndërkohë janë emëruar ose zgjedhur në funksione publike apo kanë krijuar marrëdhënie të rregullt të punës në një institucion tjetër.
5. Emërimi në thirrjet e profesorit bëhet sipas renditjes: profesor asistent, profesor i asociuar dhe profesor i rregullt. Nuk lejohet tejkalimi i thirrjes apo emërimi i parakohshëm.

¹⁴ Përparësi do të kenë folësit nativë të gjuhës,

¹⁵ Ligjëratave dhe ushtrimeve.

6. Kriteri i moshës së përcaktuar si në nenet 177 dhe 178 të statutit vlen për kandidatët të cilët aplikojnë për themelimin e marrëdhënies së rregullt të punës dhe do të merret në konsideratë deri në ditën e aplikimit në konkurs. Nëse një kandidat ka qenë i angazhuar në Universitetin e Prishtinës në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm apo me honorar para moshës së përcaktuar sipas neneve 177 dhe 178 të statutit, kjo nuk nënkupton që për të njëjtin nuk aplikohet kriteri i moshës së paraparë me statut në momentin e themelimit të marrëdhënies së rregullt të punës.
7. Bazuar në Ligjin e Punës në fuqi, kontrata për marrëdhënie të rregullt pune për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vjet, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.
8. Në Universitetin e Prishtinës nuk lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (katedër, degë, departament ose program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin bashkëshortor, prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).
9. Shtetasit e huaj dhe personat pa shtetësi në Republikën e Kosovës themelojnë marrëdhënie pune sipas Ligjit të Punës, nën kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj të veçantë për punësimin e shtetasve të huaj dhe sipas konventave ndërkombëtare.

Neni 10 **Procedurat e konkursit**

1. Procedura përzgjedhëse për emërim, riemërim ose avancim do të bëhet në mënyrë transparente dhe me shpalljen e konkursit publik për pozitën përkatëse.
2. Konkursi për emërim, riemërim dhe avancim shpallet me vendim të senatit, pas aprovimit të propozimeve të fakulteteve.
3. Fakultetet nuk mund të kërkojnë shpalljen në konkurs të pozitave të cilat lidhen me personelin e rregullt, të cilit i kanë mbetur më pak se 12 muaj deri në pension, përveç në rastet kur rrezikohet akreditimi i programit përkatës.
4. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune sipas paragrafit 3 të këtij neni nuk ka të drejtë të aplikojë në konkurs, meqë të njëjtit, me vendim të rektorit, i vazhdohet kontrata për periudhën e mbetur deri në pension.
5. Personelit të zgjedhur për pozitë sipas paragrafit 3 të këtij neni i lëshohet kontrata e punës valide pas pensionimit të personelit përkatës të rregullt në ato pozita.
6. Fakultetet propozimet e tyre duhet t'i bazojnë në nevojat reale, numrin e mjaftueshëm të fondit të orëve që duhet të ketë një vend pune, për t'u zgjedhur në thirrjen e mësimdhënësit, asistentit apo lektorit.

7. Propozimet për pozita të reja me normë të plotë mund të merren parasysh nëse fakulteti ofron dëshmi që për atë pozitë brenda një viti akademik ekziston fond i orëve:
 - 7.1. Për pozitën e mësimit të paku 50 % të orëve të parapara për normë të plotë të jenë ligjërata nga lëndët obligative, kurse pjesa tjetër e orëve ligjërata nga lëndët zgjedhore ose në Fakultetin e Mjekësisë nga praktika klinike. Norma e plotë përlogaritet brenda një viti akademik;
 - 7.2. Për pozitën e asistentit të paku 50 % të orëve të parapara për normë të plotë të jenë ushtrime nga lëndët obligative, kurse pjesa tjetër e orëve ushtrime nga lëndët zgjedhore. Norma e plotë përlogaritet brenda një viti akademik.
8. Rektori, me një arsyetim të bazuar, mund të vendosë t'i propozojë senatit shpalljen e konkursit për plotësimin e vendeve të caktuara të punës për personelin akademik, edhe nëse ai vend pune nuk është paraparë me propozimin e fakultetit.
9. Konkursi duhet të përmbajë referencën e neneve përkatëse të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe të kësaj rregulloreje.
10. Kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit me rastin e aplikimit për zgjedhje, rizgjedhje apo avancim duhet të sjellin vendimin për nostrifikimin (barasvlerën) e diplomës përkatëse (baçelor, master, magistraturë, doktoratë) ose dëshminë e aplikimit për nostrifikim.
11. Në rast të mungesës së vendimit për nostrifikim të diplomës në kohën e aplikimit për zgjedhje, rizgjedhje apo avancim, kandidati është i obliguar që para se senati të vendosë për lëndën përkatëse, të sjellë vendimin për nostrifikim të diplomës, në të kundërtën nuk mund të themelojë marrëdhënie pune me Universitetin e Prishtinës.
12. Konkursi shpallet në ueb-faqen e universitetit. Kohëzgjatja e konkursit është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike.
13. Punëdhënësi në sektorin publik është i detyruar që një kopje të shpalljes së konkursit publik ta dërgojë në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (MPMS).
14. Aplikuesit duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike.
15. Dokumentacioni i shtypur dhe i skanuar në CD duhet të dorëzohet në fakultetin përkatës, kurse versioni elektronik në adresën zyrtare të Universitetit të Prishtinës (punesimi.akademik@uni-pr.edu).

Neni 11 Komisionet vlerësuese

1. Fakulteti është i obliguar që për çdo pozitë të shpallur në konkurs ta caktojë komisionin vlerësues.
2. Brenda (10)¹⁶ ditëve pas hapjes së konkursit, dekani i fakultetit thërret mbledhjen e këshillit të fakultetit, në të cilën merret vendimi për themelimin e komisioneve vlerësuese dhe komisionit të ankesave, në përbërje prej 3 anëtarëve.
3. Anëtarë të komisionit të ankesave nuk mund të jenë strukturat udhëheqëse të fakultetit dhe departamenteve përkatëse si dhe anëtarët e komisioneve vlerësuese.
4. Anëtarë të komisionit vlerësues nuk mund të jenë strukturat menaxhuese në nivel të fakultetit dhe universitetit.
5. Komisioni vlerësues zgjedhet nga këshilli i fakultetit, me propozim të katedrës, degës, departamentit ose programit. Përfundimisht, kur është e pamundur që propozimi të bëhet nga (katedër, degë, departament ose program), komisioni vlerësues ose anëtari i komisionit vlerësues zgjedhet direkt nga këshilli i fakultetit.
6. Pjesëmarrja e personelit akademik në komisione vlerësuese është detyrim pune dhe si i tillë është i obliguar për zbatim, përveç rasteve kur identifikohet konflikti i interesit apo refuzimi arsyetohet për shkak të gjendjes shëndetësore, e cila dëshmohet me raport të mjekut.
7. Komisionet vlerësuese janë organe me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik.
8. Në komisione vlerësuese duhet të jenë së paku dy (2) anëtarë nga fusha e ngushtë me lëndët, për të cilat është shpallur konkursi.
9. Anëtarët e komisionit vlerësues duhet të kenë thirrje më të lartë akademike ose së paku të njëjtë me pozitën, për të cilën ka aplikuar kandidati.
10. Anëtari i komisionit vlerësues me thirrje më të lartë akademike, me automatizëm, është kryetar i komisionit. Në rastet kur më shumë se një anëtar i komisionit ka thirrje më të lartë, përkatësisht në rastet kur të gjithë anëtarët e komisionit kanë thirrje të njëjtë me pozitën, për të cilën ka aplikuar kandidati, kryetar do të jetë anëtari më i vjetër në moshë, përkatësisht anëtari i caktuar me koncensus.
11. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve si në paragrafin 6 dhe 7 të këtij neni, në përbërje të komisionit vlerësues mund të emërohen edhe profesorë nga departamentet tjera, por në këtë rast kryetari i komisionit duhet të jetë nga radha e profesorëve të departamentit, për të cilin janë duke u vlerësuar aplikacionet.

¹⁶ Të gjitha afatet në këtë rregullore nënkuptojnë ditët kalendarike, përveç nëse specifikohet ndryshe.

12. Anëtarët e komisionit vlerësues mund të jenë edhe nga universitete të tjera në vend dhe jashtë vendit. Në këtë rast, së paku një (1) anëtar i komisionit është i brendshëm, nga Universiteti i Prishtinës. Në rastet kur komisioni vlerësues ka dy (2) anëtarë të jashtëm, anëtari i brendshëm, me automatizëm, është kryetar i komisionit.
13. Në mungesë të anëtarëve në marrëdhënie të rregullt pune si në paragrafin 6, 7 dhe 9, anëtarë të komisionit vlerësues mund të jenë edhe personat e pensionuar, që kanë thirrjet e nevojshme akademike nga fusha përkatëse dhe të cilët nuk e kanë kaluar moshën 70-vjeçare, përjashtimisht profesorëve emeritus, të cilët kanë kontratë për mbajtjen e mësimit edhe mbi këtë moshë.
14. Në rast të arsyeve të bazuara, anëtari i komisionit, në afat prej pesë (5) ditëve pas formimit të komisionit vlerësues, mund të deklarojë me shkrim tërheqjen e tij nga komisioni. Në këtë rast, dekani i fakultetit, brenda shtatë (7) ditëve, thërret mbledhjen e këshillit të fakultetit dhe, në rast të aprovimit të dorëheqjes, kërkon nga këshilli plotësimin, përkatësisht formimin e komisionit tjetër vlerësues.
15. Administrata e fakultetit duhet t'ia ofrojë të gjithë dokumentacionin e dorëzuar komisionit vlerësues.
16. Kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar të thërrasë anëtarët e tjerë të komisionit dhe ta hartojnë raportin e vlerësimit.
17. Komisioni vlerësues është i obliguar që, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas mbylljes së konkursit, ta dorëzojë raportin e vlerësimit për kandidatët, të cilët kanë aplikuar për pozitën e caktuar.
18. Këshilli i fakultetit përkatës ka të drejtë të ndryshojë përbërjen e komisionit vlerësues, përkatësisht të formojë komision të ri, nëse konstatohet se komisioni nuk ka respektuar afatet e parapara në këtë rregullore në lidhje me raportin vlerësues.
19. Pas ndryshimit të përbërjes së komisionit vlerësues, këshilli i fakultetit i jep afat komisionit edhe dhjetë (10) ditë shtesë që të hartojë dhe ta dorëzojë raportin për kandidatët e paraqitur në konkurs.
20. Komisioni vlerësues është i obliguar që gjatë punës së tij të respektojë dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit të Prishtinës, këtë rregullore, kushtet e konkursit dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
21. Nëse komisioni vlerësues e sheh të nevojshme mund t'i ftojë në intervistë kandidatët të cilët zgjedhen për herë të parë në Universitetin e Prishtinës.
22. Komisioni vlerësues është i obliguar që t'u japë përparësi kandidatëve, të cilët i plotësojnë kriteret e nevojshme dhe të cilët, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të aktivitetit të tyre shkencor, profesional dhe akademik, janë më të mirë në krahasim

me kandidatët tjerë. Komisioni duhet të arsyetojë rekomandimin e bërë në frymën e këtij paragrafi.

23. Në raportin e komisionit vlerësues duhet të bëhet i qartë propozimi për emërimin, riemërimin ose avancimin e kandidatëve në numrin e kërkuar me konkurs dhe të dallohet nga propozimi për kandidatët, të cilët nuk janë zgjedhur.
24. Komisioni vlerësues është i obliguar të shkruajë raport edhe për kandidatët, të cilët i plotësojnë kushtet minimale, por të cilët nuk janë propozuar të emërohen. Për kandidatët, të cilët nuk i plotësojnë kushtet minimale mjafton të ceken kushtet, të cilat nuk janë plotësuar.
25. Pas hartimit dhe nënshkrimit të raportit nga të tre (3) anëtarët, kryetari i komisionit vlerësues është i obliguar që ta dorëzojë raportin në këshillin e fakultetit përkatës.
26. Nëse ndonjëri nga anëtarët e komisionit vlerësues ka mendim të ndryshëm në lidhje me propozimin për emërimin, riemërimin ose avancimin e kandidatit, ai anëtar është i obliguar që të paraqesë një “propozim të ndarë” për këshillin e fakultetit përkatës. Vlerësimet në raport bëhen në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në statut dhe të detajuara në këtë rregullore. Në raste të tilla, këshilli i fakultetit i diskuton të dyja propozimet dhe e dorëzon në rektorat propozimin që është miratuar nga këshilli, duke përfshirë informacionin për mendimet e ndara. Këshilli i fakultetit mban të drejtën të refuzojë të dyja propozimet, por nuk mund t’i miratojë të dyja propozimet për të njëjtën pozitë.
27. Në raportin e këshillit të fakultetit duhet të bëhet i qartë propozimi për emërimin, riemërimin ose avancimin e kandidatëve në numrin e kërkuar me konkurs.
28. Anëtarët e komisionit vlerësues mbajnë përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit dhe për rekomandimet që bëjnë do të sanksionohen sipas kodit të etikës dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi, nëse të njëjtat bien qartazi ndesh me Statutin e UP-së dhe këtë rregullore.

Neni 12

Procedura pas dorëzimit të raportit nga komisioni vlerësues

1. Këshilli i fakultetit, pas dorëzimit të raportit nga komisioni vlerësues, është i obliguar që në mbledhjen e radhës, jo më vonë se shtatë (7) ditë, të shqyrtojë raportin dhe të konstatojë kryerjen e punëve në lidhje më raportin e komisionit vlerësues.
2. Këshilli i fakultetit përkatës, pas mbajtjes së mbledhjes dhe konstatimit të gjendjes së raporteve vlerësuese, brenda tre (3) ditëve, i përcjell raportet e kompletuara vlerësuese në versionin elektronik pranë zyrës për çështje akademike të universitetit.

3. Zyra për çështje akademike e universitetit është e obliguar që brenda shtatë (7) ditëve pas marrjes së raporteve vlerësuese nga ana e këshillave të fakulteteve, të hartojë buletinet dhe të njëjtit t'i publikojë në ueb-faqen e universitetit.
4. Buletinet duhet të qëndrojnë të publikuara në ueb-faqe të universitetit në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e publikimit.
5. Zyra për çështje akademike, nëse konstaton se ndonjë nga raportet e dorëzuara nga këshilli i fakultetit përkatës nuk është në rregull me dokumentacion, atëherë duhet të kërkojë nga prorektori për mësim që ta obligojë fakultetin përkatës që të kompletojë dokumentacionin para se të dalë në buletin.
6. Gjatë fazës së publikimit të raporteve të komisioneve vlerësuese në buletine, kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë të parashtrajnë ankesë në këshillin e fakultetit përkatës.
7. Ankesat eventuale të kandidatëve duhet të dorëzohen në administratën e fakultetit përkatës.
8. Këshilli i fakultetit është i obliguar që pas kalimit të afatit të buletineve, në afat prej dhjetë (10) ditëve, të vlerësojë raportet e komisioneve vlerësuese dhe të vendosë për miratim ose jo të atyre raporteve.
9. Gjatë shqyrtimit të raporteve, këshilli i fakultetit është i obliguar që të shqyrtojë edhe raportin e komisionit të ankesave lidhur me ankesat e kandidatëve, të parashtruara në fazën e publikimit të buletineve dhe ndaj ankesave të japë përgjigje me shkrim.
10. Këshilli i fakultetit është i obliguar që, pas shqyrtimit dhe miratimit ose jo të raporteve të komisioneve vlerësuese, vendimin përkatës dhe detajet e tjera rreth shqyrtimit të ankesave t'i dorëzojë brenda tre (3) ditëve pranë zyrës për çështje akademike të universitetit.
11. Zyra për çështje akademike, nëse konstaton se ka ndonjë lëshim në materialin e dorëzuar nga fakultetet përkatëse, është e obliguar që ta informojë prorektorin për mësim, i cili kërkon nga dekanati i fakultetit përkatës që t'i kompletojë lëndët.

Neni 13

Shqyrtimi i propozimit të këshillit të fakultetit në senat

1. Në bazë të nenit 28, paragrafi 1.16 të Statutit të UP-së, rektori formon komision këshillëdhënës lidhur me rregullsinë e procedurës dhe propozimeve nga fakultetet për kandidatët e paraqitur në konkurs.
2. Në një afat prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimin të propozimeve të këshillit të fakultetit, zyra për çështje akademike përgatit për senat pasqyrat me propozimet

përkatëse, përfshirë propozimin e rektorit lidhur me propozimet e këshillit të fakultetit.

3. Vendimi i senatit lidhur me propozimet e këshillave të fakulteteve merret më së largu njëzet (20) ditë pas përgatitjes së pasqyrave nga zyra për zhvillim akademik.
4. Nëse senati vendos ta refuzojë propozimin e këshillit të fakultetit, lënda përkatëse, brenda tri (3) ditëve, kthehet për rishqyrtim në këshillin e fakultetit.
5. Këshilli i fakultetit obligohet që brenda shtatë (7) ditëve pas pranimi të vendimit të senatit të rishqyrtojë lëndët për rivlerësim dhe vendimin përkatës ta dorëzojë, brenda tri (3) ditëve, pranë zyrës për çështje akademike të universitetit.
6. Nëse këshilli i fakultetit, edhe pas rishqyrtimit, sjell të njëjtin propozim, senati, në një afat jo më të gjatë se njëzet (20) ditë nga pranimi i tyre, merr vendim përfundimtar.
7. Senati rezervon të drejtën që në çdo moment ta tërheqë të drejtën e njohjes së publikimit në revistat, të cilat janë të dyshimta.

Neni 14

Vendimi, periudha e ankimimit dhe kohëzgjatja e konkursit

1. Procedura e votimit në senat për propozimet e këshillit të fakultetit lidhur me emërimin dhe avancimin e anëtarëve të personelit akademik bëhet sipas rregullores së punës të senatit.
2. Anëtari i personelit akademik, i cili ka vlerësim pozitiv nga instancat paraprake, por i cili nuk i fiton votat e nevojshme të anëtarëve të senatit për avancim, mbetet në thirrjen e njëjtë.
3. Ndaj vendimit të senatit, në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimi të dorëzimit të njoftimit për vendim, mund të bëhet ankesë në Komisionin e Senatit për Ankesa dhe Parashtresa, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimimit në UP.
4. Konkursi për emërim, riemërim ose avancim të personelit akademik duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UP-së për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.
5. Për raste të veçanta para arritjes së propozimit në senat, me kërkesë të rektorit, afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet edhe maksimumi në 30 ditë.
6. Nëse konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar si në paragrafin 4 të këtij neni, atëherë vendet përkatëse të përcaktuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së fakultetit.

7. Kontrata e punës për personelin akademik të zgjedhur për herë të parë në Universitetin e Prishtinës, sipas vendimit të senatit, do të nënshkruhet vetëm nëse për lëndën përkatëse, brenda afatit ligjor, nuk ushtrohet ankesë, respektivisht në rast të ankesës, deri në një vendim përfundimtar të Inspektoratit të Punës.

Neni 15 Dispozitat kalimtare

1. Punimet që botohen pas datës 1 qershor 2020 do të merren parasysh vetëm nëse janë të publikuara në revista ndërkombëtare të indeksuara ndërkombëtarisht në platformat:
 - 1.1. Web of Science: Core Collection (<http://mjl.clarivate.com/>)
 - 1.2. Scopus (Elsevier) (<https://www.scopus.com>).
2. Për emërimet dhe avancimet e personelit akademik nga data 1 janar 2023, do të merren parasysh vetëm punimet e publikuara në revista (të indeksuara ndërkombëtarisht) ndërkombëtare në frymën e neneve 175, 176 dhe 177 të Statutit të UP-së, të cilat janë të specifikuara në shtojcën II, paragrafi A.2.1, alineja 1 dhe 2, respektivisht:
 - 2.1. Web of Science: Core Collection (<http://mjl.clarivate.com/>)
 - 2.2. Scopus (Elsevier) (<https://www.scopus.com>).
3. Nga data 1 janar 2023, bëhen të pavlefshëm paragrafët e shtojcës II të rregullores dhe atë si në vijim;
 - 3.1. Paragrafi A.2.1, alineja 3, 4 dhe 5;
 - 3.2. Paragrafi A.2.2. alineja 1, 2 dhe 3;
 - 3.3. Paragrafi A.2.3, me të gjitha alinetë (1-16);
 - 3.4. Paragrafi A.2.4, me të gjitha alinetë (1-10);
 - 3.5. Paragrafi A.3 dhe
 - 3.6. Paragrafi A.4.
4. Ky nen nuk do të aplikohet për riemërimet në thirrjet akademike të fituara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 16 Dispozitat përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja nr. 1/342, dt. 11.5.2018, për korrigjimet teknike të rregullores nr. 465, dt. 02.03.2018, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe rregullorja nr. 465, dt.

02.03.2018, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit.

Kryesues i Senatit të Universitetit të Prishtinës

Prof. dr. Marjan Dema, rektor i UP-së



Shtojca I

FORMULAR PËR AKTIVITETIN ARSIMOR (MËSIMDHËNIEN)

Tabela I.1 Aktivitetet mësimore, me përqendrim te përvoja relevante

Emri & niveli i lëndës sipas viteve të periudhës që recensohet	Viti & semestri kur ligjërohet	Numri i përafërt i studentëve	Numri i orëve për semestër	Forma e mësimdhënies (p.sh., ligjërata, mësim në ekip, tutorim, mbikëqyrje e punës praktike, online, punë në laborator)

Tabela I.2 Cilësia në mësimdhënie¹⁷

Aktiviteti	Vlerësimi i aktivitetit
Vlerësimi i mësimdhënies nga studentët etj. (pozitiv/negativ)	

Tabela I.3 Mentorimi

Emri i kandidatit	Diploma / niveli i studimit ¹⁸	Data e regjistrimit / lejimit të punimit	Në proces	Data e përfundimit

¹⁷ Fillon të zbatohet nga momenti i sigurimit të sistemit meritore të vlerësimit të studentëve.

¹⁸ Punimi i diplomës në studimet 5 ose 6 vjeçare, lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik, konsiderohet ekuivalent me punimin e nivelit Master.

Tabela I.4 Shpërblime dhe trajnime në mësimdhënie

Shpërblimi/trajnimi	Data/periudha	Përshkrimi i shkurtë

Vërejtje: Për aktivitetet lidhur me tabelën 1.4 kandidatët në marrëdhënie të rregullt pune në UP duhet të ofrojnë dëshmi që kanë vijuar me sukses së paku 2 trajnime për mësimdhënie (përfshirë në konkursin e parë që shpallet pas miratimit të kësaj rregulloreje, mund të pranohen edhe dëshmitë e aplikimit).

Shtojca II

FORMULAR PËR AKTIVITETIN HULUMTUES, SHKENCOR DHE PROFESIONAL

A. Autori i parë, autori korrespondent dhe punimet e publikuara në revista ndërkombëtare në frymën e neneve 175, 176 dhe 177 të Statutit të UP-së

Në përputhje me Statutin e UP-së, punimi i publikuar në revistë ndërkombëtare shkencore mund të shfrytëzohet për nevoja të emërimit, riemërimit dhe avancimit nga autori i parë i punimit dhe nga autori korrespondent.

A.1. Për autorin korrespondent të punimit të publikuar në revistë ndërkombëtare shkencore vlejné përkufizimet vijuese:

- a) Si autor korrespondent konsiderohet autori i cili është i identifikuar si i tillë në punimin e publikuar;
- b) Nëse në punimin e publikuar janë specifikuar më shumë se një autor korrespondent, si autor korrespondent konsiderohet autori i parë i identifikuar si i tillë;
- c) Nëse në punimin e publikuar janë vetëm dy autorë dhe autori korrespondent nuk është specifikuar, autori i dytë konsiderohet si autor korrespondent.

A.2. Bazuar në statutin e UP-së dhe aktet tjera ligjore në fuqi, si punime të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore gjatë vlerësimit të kandidatëve të paraqitur në konkurs vlejné punimet e publikuara në fushën e kandidatit, në revista të cilat janë të indeksuara në bazat përkatëse akademike dhe të kategorizuara si në vijim:

A.2.1. Punimet e publikuara në revista të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me 1:

1. Web of Science: Core Collection (<http://mjl.clarivate.com/>)
2. Scopus (Elsevier) (<https://www.scopus.com>)
3. EBSCOhost (<https://www.ebscohost.com/academic>)
4. WorldCat (<http://www.worldcat.org>)
5. Directory of Open Access Journals (<http://www.doaj.org>)

A.2.2. Punimet e publikuara në revista të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me 0.85:

1. WorldWideScience (<http://www.worldwidescience.org>)
2. Microsoft Academic Search (<http://academic.research.microsoft.com>)
3. BASE (Bielefeld Academic Search Engine) (<https://www.base-search.net>)

A.2.3. Punimet e publikuara në revista të cilat janë të indeksuara në bazat akademike vijuese barasvlerësohen me 0.70:

1. Scimago Journal & Country Rank (<http://www.scimagojr.com>)
2. PubMed (<http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed>)
3. ERIH PLUS (<https://dbh.nsd.uib.no/publiseringskanaler/erihplus>)
4. HeinOnline (<https://home.heinonline.org/>)
5. CrossRef (<http://www.crossref.org>)
6. Central and Eastern European Online Library (<https://www.ceeol.com>)
7. Hrvatska znanstvena bibliografija (<https://bib.irb.hr/>)
8. ULAKBIM – National Academic Network and Information Center (<http://cabim.ulakbim.gov.tr/tr-dizin/tr-dizinde-dizinlenen-dergi-listesi>)
9. CAB Direct (<https://www.cabdirect.org/cabdirect/>)
10. zbMATH (<https://zbmath.org>)
11. IEEE Xplore Digital Library (<https://www.ieee.org/index.html>)
12. DBLP-Computer Science Bibliography (<http://dblp.uni-trier.de/>)
13. ProQuest (<http://www.proquest.com/libraries/academic/databases>)
14. Open akademik Journals Index (<http://oaji.net/>)
15. JSTOR (<https://www.jstor.org/>)
16. ERIC- Education Research Information Center (<https://eric.ed.gov/>)

A.2.4. Punimet e publikuara në revistat vijuese barasvlerësohen me 0.55:

1. South-East European Journal of Ophthalmology (<http://www.seeos.eu/>)
2. Studime (<http://www.ashak.org/?cid=1,31>)
3. Studime albanologjike (<https://www.fhf.edu.al/?s=studime+albanologjike>)
4. The Journal of International Turkish Language & Literature Research (<http://dedekorkutdergisi.com/OncekiSayilar.aspx>)
5. Cahiers d'histoire culturelle (<https://www.entrevues.org/revues/cahiers-dhistoire-culturelle/>)
6. Medien & Zeit (<http://medienundzeit.at/>)
7. Kuwait Journal of Science (<https://journalskuwait.org/>)
8. South-East European Journal of Earth Observation and Geomatics (<https://ejournals.lib.auth.gr/seejeog/index>)
9. International Journal of Contemporary Architecture- The New ARCH (<http://the-new-arch.net/>)
10. Gjurmime Albanologjike (<http://www.institutialbanologjik.com/index.aspx?SID=19&LID=2&AID=1175&Ctype=1&ACatID=15>)

11. Music Theory Spectrum (Oxford Academy) UK
<https://academic.oup.com/mts/pages/About>
12. Grove Music Online Dictionary (Oxford Music Online) UK
<http://www.oxfordmusiconline.com/>
13. The Musicologist (International Journal of Music Studies) TURKEY
<http://musicologistjournal.com>
14. Acta Musicologica (International Musicological Society) SWISS
<https://www.acta-musicologica.net>
15. The World of Music (Journal of Musicology of Georg August University – Gottingen) GERMANY
16. <http://www.journal-the-world-of-music.com>

A.3. Punimet e publikuara në revistat 3, 4 dhe 5 të nënparagrafit A.2.1 si dhe në revistat si në nënparagrafët A.2.2, A.2.3 dhe A.2.4, nuk merren parasysh gjatë vlerësimit të kandidatëve nëse revistat përkatëse janë të përfshira në lista të revistave dhe botuesve të dyshimtë¹⁹, përkatësisht në listën origjinale të Beall-it lidhur me revistat dhe botuesit e dyshimtë:

1. (<https://web.archive.org/web/20170111172309/https://scholarlyoa.com/individual-journals/>;
2. <https://web.archive.org/web/20170111172306/https://scholarlyoa.com/publishers/>)

A.4. Si punime të publikuara në revista ndërkombëtare shkencore vlejné punimet e publikuara në revista të botuara jashtë Kosovës dhe jashtë vendeve fqinje të Kosovës, përveç në rastin e kandidatëve të cilët vijnë nga fusha e shkencave të albanologjisë, për të cilët vlejné edhe punimet në revista të Kosovës dhe Shqipërisë me redaksi ndërkombëtare.

Tabela II.1 Publikimet në revista ndërkombëtare që plotësojnë kushtet si në paragrafët A1 deri A4

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti	Linku identifikues ²⁰

¹⁹ Revista të dyshimta konsiderohen revistat, të cilat nuk e aplikojnë procesin e vërtetë të recensionit profesional (peer review), nuk kanë ISSN të vërtetë, nuk kanë uebfaqe ose kanë një të tillë të dyshimtë, personi juridik apo fizik botues nuk ka adresë ose numër kontakti, deklaron adresë ose numër kontakti fiktiv, paraqet indeksim ndërkombëtar të rremë, deklaron faktor ndikimi të rremë, botuesi i tyre është i dyshimtë në kuptimin e mënyrës së menaxhimit dhe paletës së revistave që publikon.

²⁰ Komisioni vlerësues është i obliguar të shënojë linkun, nëpërmjet të cilit dëshmohet indeksimi i punimit, përkatësisht revistës në bazën e caktuar akademike, respektivisht linkun e punimit në revistën përkatëse të nënparagrafit A.2.4.

Vërejtje: Për thirrjen prof. i rregullt kandidati duhet t'i ketë së paku 5 punime, për thirrjen prof. i asociuar, së paku 3 punime, për thirrjen prof. Asistent, së paku 1 punim nga kjo kategori.

B. Publikimet në revista akademike ose shkencore, ndërkombëtare ose vendore që nuk janë përfshirë në tabelën II.1 (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela II.2 Publikimet në revista akademike ose shkencore ndërkombëtare

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti

Tabela II.3 Publikimet në revista akademike ose shkencore vendore

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Revista	Vëllimi, nr., faqet, viti

C. Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve në fushën e kandidatit (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela II.4 Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve etj. në gjuhë të huaja

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i publikimit	Lloji i publikimit	Shtëpia botuese, vendi, viti

Tabela II.5 Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve etj. në gjuhën shqipe

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i publikimit	Lloji i publikimit	Shtëpia botuese, vendi, viti

D. Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminarët, workshopet (në cilësinë e autorit të parë ose bashkautorit)

Tabela II.6 Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminarët, workshopet në nivel ndërkombëtar (jashtë vendit)

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Vëllimi, nr., faqet, viti

Tabela II.7 Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminarët, workshopet vendore

Nr	Autorët (renditja si në punim)	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Vëllimi, nr., faqet, viti

E. Aktiviteti tjetër kërkimor shkencor

Tabela II.8 Ligjëratat - prezantimet gojore shkencore në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore dhe në universitete (si ligjërues i ftuar) nga fusha e kandidatit

Nr	Autorët (renditja si në Ligjëratë/prezantim)	Titulli i prezantimit	Lloji i ligjëratës (konferencë, simpozium, punëtori, universitet)	Viti, vendi

Tabela II.9 Redaktor/recensent në revistat akademike apo shkencore

Nr	Kontributi (redaktor/recensent)	Autori origjinal i punimit	Titulli i punimit të recensuar	Revista e cila është redaktuar ose për të cilën është shkruar recension	Vendi, viti

Tabela II.10 Kontribute tjera shkencore dhe profesionale

Nr	Autorët (renditja si në kontributin shkencor)	Lloji i kontributit shkencor	Viti, vendi

F. Kontributi në projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme**Tabela II.11** Pjesëmarrja e dëshmuar në programe ose projekte të kërkimeve themelore dhe të aplikueshme

Nr	Programi/ projekti shkencor	Periudha kohore	Institucioni/ vendi	Pozita në program, projekt/ kontributi

G. Patente në nivel ndërkombëtar ose kombëtar**Tabela II.12** Patentë zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar

Nr	Autorët (renditja si në patentën e zyrtarizuar)	Titulli i patentës	Institucioni/ vendi, viti i zyrtarizimit	Faqet

Shtojca III

FORMULAR PËR AKTIVITETIN SHËRBYES

Kjo shtojcë përfshin aktivitetin në shërbim të universitetit, fakultetit dhe komunitetit nëpërmjet shërbimit specifik, përkatësisht pjesëmarrjes në komitete/komisione akademike, administrative ose ekipe profesionale.

Tabela III.1 Shërbimi në lidhje me universitetin

Shërbimi, përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë i shërbimit

Tabela III.2 Shërbimi në lidhje me fakultetin

Shërbimi, përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë i shërbimit

Tabela III.3 Shërbimi në lidhje me komunitetin

Shërbimi, përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrim i shkurtë i shërbimit